



VENDIM

Nr 126 Datë. 01.12. 2014

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “FUTURE ENERGY AL” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Future Energy AL” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “**FUTURE ENERGY AL**” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte
- Neni 9, pika 2
Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. Mungon vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata që personi nuk është i përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë
- Neni 9, pika 3
Dokumentacioni finaciar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 4/10, gërma a e plotësuar në mënyrë korrekte
- Neni 9, pika 4/10, gërma b e plotësuar në mënyrë korrekte
- Neni 9, pika 4/10, gërma c e plotësuar në mënyrë korrekte

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit të Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë **“Future Energy AL” sh.p.k.**, për licencimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve

VENDIM

Nr.126 Datë. 01.12.2014

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “FUTURE ENERGY AL” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
